



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 255 Prot.

Tiranë, më datë 14.06.2019

VENDIM

Nr.213, datë 14.06.2019

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2 dhe neni 72, pika 1, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 14.06.2019, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projekt - idesë “Restaurimi i Mozaikut “Shqiptarët” në fasadën e Muzeut Historik Kombëtar, kërkesë e “ATELIER 4” sh.p.k;
- *Miratohet Varianti II-të;*
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1;
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elysa MARGARITI

SEKRETARI KKR

Arta Dollani

